



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE Vlorë

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe baza ligjore

1. DRTK-Vlorë, në përmbushje të detyrave të saj funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit Nr.27/2018, lidhur me:
 - a) Organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë (DRTK-Vlorë);
 - b) Administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të DRTK- Vlorë.
2. Funksionimi i DRTK-Vlorë mbështetet në Nenin 119 të Kushtetutës, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimit nr. 581, datë 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, të Këshillit të Ministrave si dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 28.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

Neni 2

Misioni dhe veprimtaria

1. DRTK-Vlorë është institucion rajonal i specializuar, tekniko-administrativ buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore që ushtron veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore, me seli në Vlorë.
2. DRTK-Vlorë financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. DRTK-Vlorë ushtron veprimtarinë e saj në fushën e trashëgimisë kulturore me qëllim gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore në territorin që administron.
4. Në veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve, DRTK-Vlorë monitorohet dhe koordinohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK), si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve. DRTK-Vlorë bashkëpunon dhe bashkërendon punën me:

- a) Institucionet e tjera në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) Organet e administratës qendrore;
- c) Organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) Institucion dhe organizata të tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë dhe juridikë për gjurmimin, evidentimin, studimin, konservimin, restaurimin, promovimin dhe publikimin e pasurive kulturore.

5. DRTK-Vlorë ka këto kompetenca:

- a) zbatonë konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore.
- b) Gjurmonë dhe përgatit vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes.
- c) kryen verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura.
- d) harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi ,projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor.
- e) kryen punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara.
- f) Kryen mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore dhe materiale.
- g) kryejnë çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

6. DRTK- Vlorë ushtron veprimtarinë në:

- a) Qarkun e Vlorës dhe në atë të Fierit.
- b)
- c) Bashkinë Vlorë,
- d) Bashkinë Sarandë;
- e) Bashkinë Finiq;
- f) Bashkinë Himarë;
- g) Bashkinë Selenicë;
- h) Bashkinë Fier;
- i) Bashkinë Mallakastër.

7. DRTK-Vlorë realizon aktivitetin nën monitorimin e koordinimin e IKTK-së dhe në bashkëpunim me:
- a) institucionet e tjera në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - b) organet e administratës qendrore;
 - c) organet e vetëqeverisjes vendore;
 - d) institucionet e tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë e juridikë për gjurmimin, evidentimin, studimin, konservimin, restaurimin, promovimin e publikimin e pasurive kulturore.
8. Statuti dhe rregullorja që përcaktojnë metodat e brendshme të punës për DRTK- Vlorë, miratohen nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.